



ГРАД СКОПЈЕ - QYTETI I SHKUPIT

Бр. Nr.

08-6025/4
15-05-2026

20

СКОПЈЕ - SHKUP

QYTETI I SHKUPIT
SEKTORI PËR ZHVILLIM LOKAL EKONOMIK
SHKUP

**BASHKËNGJITJE E APLIKIMIT
PËR NDARJEN E MJETEVE PËR FINANCIMIN E FESTIVALEVE, EVENTEVE DHE
MANIFESTIMEVE NGA FUSHA E TURIZMIT DHE HOTELERISË**

**PËRMBAJTJA DHE KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOHEN NGA ANA E
REALIZUESIT TË MANIFESTIMIT: „Street food Festival”**

1. PËRMBAJTJA E MANIFESTIMIT:

- Manifestimi pritet të jetë destinacion argëtimi me përmbajtje të pasur muzikore dhe performanca nga interpretues dhe grupe vokale, si dhe për shijimin e ushqimeve cilësore duke ndërthurur kuzhinën moderne dhe tradicionale, vendase dhe ndërkombëtare, në mënyrë tërheqëse dhe argëtuese, në të cilën do të marrin pjesë kompani të vogla, aktiviteti kryesor i të cilave është përgatitja dhe shitja e ushqimeve dhe pijeve të shpejta në rrugë. Manifestimi pritet të zhvillohet në Parkun e qytetit në Shkup, në stenda të specializuara për ushqim të shpejtë.
- Të ofrojë listë bashkëpunimi dhe ftesa për pjesëmarrjen e kompanive dhe shoqatave për përgatitjen e ushqimeve;
- Të ftojë që të jenë pjesë e këtij manifestimi grupe muzikore të njohura vendase dhe të huaja;
- Të ofrojë draft projekt të shkurtër për zhvillimin e manifestimit të ushqimit të rrugës;
- Të sigurojë stenda/shtëpiza përfaqësuese për prezantimin dhe përgatitjen e ushqimit.
- Ceremonia e hapjes së manifestimit nga ana e kryetarit të Qytetit të Shkupit;
- Pastrimi i vendit dhe kthimi i tij në gjendjen përpara përdorimit.

2. KUSHTE PËR REALIZIMIN E MANIFESTIMIT:

- Përvojë në organizimin dhe koordinimin e manifestimeve dhe festivaleve të karakterit të hapur dhe të mbyllur, minimum tri vite;
 - Koha e mbajtjes – Në konsultim me Qytetin e Shkupit;
 - Vendi: Sheshi te shatërvani “Lulja e Lotusit”- Parku i qytetit ose lokacion atraktiv në konsultim me Qytetin e Shkupit;
- Infrastruktura: (në marrëveshje me Qytetin e Shkupit):
 - rrethimi i hapësirës ku do të zhvillohet manifestimi,
 - sigurimi i vendit ku do të mbahet manifestimi me energji elektrike,
 - zërimi dhe ndriçimi adekuat sipas vendndodhjes dhe objekteve,
 - instalimi hidraulik,
 - sigurimi i pajisjeve sanitare të lëvizshme për të ruajtur higjienën e manifestimit (kontratë me kompani adekuate),
 - sigurimi dhe mirëmbajtja e higjienës në bashkëpunim me Ndërmarrjen publike “Higjiena Komunale” –Shkup.
 - numër adekuat tualetesh të lëvizshme sipas numrit të mysafirëve që priten,

- mini-fugon -shitës dhe stenda të specializuara të ushqimit të shpejtë, sportele, tavolina dhe stola për vizitorët
- pjesëmarrja e kompanive të vogla dhe startup që ofrojnë ushqime cilësore duke kombinuar kuzhinën moderne dhe tradicionale, vendase dhe ndërkombëtare, në mënyrë tërheqëse dhe argëtuese, e cila mund të konsumohet si ushqim rruge (i shpejtë);
- sigurimi i animacionit adekuat aktiv të manifestimit sipas programit të manifestimit: draft i shkurtër skicë për vendin e manifestimit me propozim ide për pjesëmarrësit,
- sigurimi i pajisjeve adekuate për logjistikën e manifestimit, skena dhe zërimi;
- në të gjitha materialet promovuese të shtypura dhe video të vendoset logoja e Qytetit të Shkupit;
- elemente të tjera të infrastrukturës që do të propozohen nga realizuesi dhe ekspozuesit.
- Sigurimi (në marrëveshje me Qytetin e Shkupit dhe MPB-në);
- Përgatitja e materialeve përfaqësuese dhe promovuese (poster, fletëpalosje, broshurë, mirënjohje);
- Mbulimi mediatik i manifestimit, si nga media elektronike ashtu edhe ajo e shkruar (një javë para manifestimit, reklamat dhe videot të transmetohen në disa stacione televizive dhe radioje) dhe sigurimi i prezantimit të duhur të manifestimit në mediumet sociale;
- mbajtja e evidencës së veçantë të dokumenteve për të ardhurat dhe shpenzimet në lidhje me organizimin e manifestimit, e cila pas përfundimit të manifestimit do t'i dorëzohet Qytetit.

3. KRITERE PËR NDARJEN E KONTRATËS SIPAS THIRRJES PUBLIKE

Si mbajtës i kontratës sipas Thirrjes publike do të zgjidhet ai aplikim që vlerësohet si më i volitshmi nga shuma e pikëve për secilin element në veçanti.

Kritere	Numri maksimal i pikëve
1. Organizimi i strukturës organizative dhe burimet	30
1.1 Aplikanti ka strukturën e nevojshme organizative dhe burimet njerëzore për realizimin e manifestimit (të punësuar, vullnetarë aktivë, persona të angazhuar me honorar etj)	10
1.2 Aplikanti disponon logjistikë (zyrë dhe pajisje teknike për realizimin e manifestimit)	10
1.3 Dukshmëria e aplikantit në internet	10
2. Financimi i propozim projektit për realizimin e manifestimit	30
2.1 Plan financiar i detajuar për mjetet e nevojshme për realizimin e manifestimit	10
2.2 Aplikanti siguron përqindje të pjesëmarrjes së tij në realizimin e projektit.	10
2.3 Plan financiar real (përshkrimi i shpenzimeve sipas kategorive të pozicioneve korrespondon me çmimet e tregut)	10
3. Cilësia e propozim projektit për realizimin e manifestimit	40
3.1 Objektiv i përgjithshëm i qartë dhe i përcaktuar në mënyrë adekuate i propozim projektit që do të kontribuojë në realizimin e prioriteteve të dhëna nga Programi i	10

aktiviteteve në fushën e zhvillimit lokal ekonomik të Qytetit të Shkupit.	
3.2. Zgjidhje cilësore dhe inovative të ofruara në projekt propozim	10
3.3 Sigurimi i përfshirjes së institucioneve dhe organizatave të tjera	10
3.4 Propozim projekti për zbatimin e manifestimit është i qartë dhe i realizueshëm.	10

Çdo fushë e kriterëve të veçanta do të vlerësohet me 1 pikë, 5 pikë ose 10 pikë, me kuptimin e mëposhtëm: 1-jo, 5-pjesërisht dhe 10-po.

***Vërejtje:**

- Të depozitohen biografite e organizatorëve të manifestimit;
- Të depozitohen pëlqim i nënshkruar për aplikim për interes për pjesëmarrje në manifestim, për secilin pjesëmarrës në veçanti ;
- Të citohet përvoja e aplikantit në organizimin e manifestimit (gjatë vlerësimit do të merret parasysh organizimi i manifestimeve të llojit të ngjashëm për sa i përket masivitetit të manifestimit, kohëzgjatjes etj.);
- Në propozim projektin e depozituar duhet të përfshihet programi zbatimës (emra muzikorë etj.);
- Në projekt propozimin e depozituar duhet të përfshihet lista e pjesëmarrësve që do të marrin pjesë në manifestim.



Kryetari i Qytetit të Shkupit
Orce Gjorgjievski